



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ**

Nr. 268 prot.

Kamëz, më 03.04.2025

V E N D I M

Nr. 268, Datë 03.04.2025

**“PËR
“PËRCAKTIMIN E VENDEVE TË AFISHIMIT TË MATERIALEVE
PROPAGANDISTIKE DHE RREGULLAT PËR AFISHIMIN E TYRE GJATË
FUSHATËS ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025”**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të nenit 79 të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjit nr. 8580, datë 17.02.2020 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar; Ligjit nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”, i ndryshuar; Udhëzimit nr. 06, datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”;

V E N D O S A:

1. Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, lejohet përdorimi dhe afishimi i materialeve propagandistike në një distancë prej 5 (pesë) metrash nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës, jo më parë se 30 (tridhjetë) ditë para datës së zgjedhjeve;
2. Ndalohet afishimi i materialeve propagandistike në fasadat e godinave të banimit, institucioneve publike apo ambienteve rrethuese pranë e rreth tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, në pemët e qytetit, në shtyllat e ndriçimit si dhe në mjete që operojnë në transportin publik;
3. Të gjitha subjektet zgjedhore duhet të njoftojnë me shkrim për adresat e sakta të zyrave elektorale. Brenda 5 (pesë) ditëve kryhet verifikimi i vendndodhjes së tyre në respektim të dispozitave të Udhëzimit nr. 6 datë 23.03.2021 të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, për afishimin dhe vendosjen e materialeve propagandistike;
4. Caktimin e ambienteve publike pranë zyrave të Lagjes Administrative Bathore, Lagjes Administrative nr. 1 dhe Lagjes Administrative nr. 2 Kamëz, Njësia Administrative Paskuqan dhe pranë ambienteve të Pallatit të Kulturës, Bashkia Kamëz, lejohet afishimi i

materialeve edukative zgjedhore, në dispozicion të KQZ-së ose palëve të treta që nuk promovojnë fushatën e një subjekti të caktuar zgjedhor por që i shërbejnë edukimit të zgjedhësve lidhur me të drejtat e tyre dhe procedurat e regjistrimit dhe votimit sipas kudit zgjedhor;

5. Nëse materialet propagandistike të subjekteve zgjedhore vendosen në kundërshtim me këtë vendim, Policia Bashkiake në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, merr masa të menjëhershme për heqjen e tyre.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

